



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 paragrafi 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESËS SË DETYRËS TË** **DREJTORIT/ESHËS TË DREJTORISË SË BUXHETIT DHE** **FINANCEVE**

Neni 1

znj. Arbnorë Uka Osmani, me kualifikim Bachelor i Ekonomisë - Drejtimi Banka, Financa dhe Kontabilitet, nga Podujeva, emërohet;

➤ **Ushtruese e Detyrës së Drejtorit/eshës të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave**

Neni 2

E përmendura në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarës
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-016101-000 7089126
Podujevë, datë: 02-02-2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16 dhe 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESES SË DETYRËS TË** **DREJTORIT/ESHËS TË DREJTORISË SË ADMINISTRATËS**

Neni 1

znj.Ditjona Statovci, me kualifikim Menaxhment Biznes dhe Ekonomi, nga fshati Batllavë-Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Ushtruese e Detyrës së Drejtorit/eshës të Drejtorisë së Administratës**

Neni 2

E përmendura në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse Kryetari i Komunës me vendim të veçantë vendos ndryshe.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarës
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot 02-020/05-0007289/26
Podujevë, datë: 03.02.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të datës 02.12.2025 të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej njëzet e shtatë mijë e njëqind euro (27100 €) ndihmë për njëqind e tridhjetë e pesë (135) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin janar 2026, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/03-0007522/26
Podujevë, datë 03.02.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 paragrafi 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESËS SË DETYRËS TË** **DREJTORIT/ESHËS TË DREJTORISË SË KULTURËS RINISË DHE** **SPORTIT**

Neni 1

znj.Valbona Ibishi Azemi, me kualifikim juriste & MSC Gjuhë Angleze, nga fshati Orllan-Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Ushtruese e Detyrës së Drejtorit/eshës të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit**

Neni 2

E përmendura në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarës
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-016/01-0007521/26
Podujevë, datë: 03.02.2026



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

znj.Zanë Fazliu, zyrtare për gjeodezi në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se tre (3) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarës

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

*E Autorizuara
Drejtorja e Inspeksionit
Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva*

Nr.prot. 02-016101-0007656126
Podujevë, datë: 04.02.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-02/01-0050862/18, nenet 3.3; 11.1 dhe 22 të Rregullores (komunale) për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/01-0062888/25, të datës 29.09.2025, për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore 2027-2028, në implementim të projektit "Përkrahje me Mëshqerra" sipas Ftesë Publike nr.prot.12-320/01-0069921/25 të datës 31.10.2025, në Rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0078988/25 të datës 08.12.2025, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare në shumë totale 428,004.00€, nga e cila 299,602.8€ apo 70% e vlerës financim nga Komuna e Podujevës, kurse pjesa tjetër prej 128,401.2€ apo 30% e vlerës së projektit është participimit nga ana e fermerëve përfitues në projektin e Komunës "Përkrahje me Mëshqerra", përkatësisht për 162 fermer/e përfitues.

2. Mbështetja e fermerëve sipas këtij vendimi bëhet konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike përkatëse për aplikim në projektin "Përkrahje me Mëshqerra".

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista përfundimtare e fermerëve të përzgjedhur për implementimin e projektit "Përkrahje me Mëshqerra". sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave si dhe Komisionin përkatës sa i përket verifikimit, konstatimit dhe vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara në Ftesën publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/03-000 7944/26
Podujevë, datë, 05.02.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja k) dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, neni 25 paragrafi 1.2 të Ligjit Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit nr.03/L-164, nenet 16, 19 paragrafi 1.11) dhe 61 paragrafi 1.7) të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM

PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR TË BANIMIT 2026-2028 NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për hartimin e propozimit të Programit trevjeçar të banim në Komunën e Podujevës për periudhën kohore 2026-2028, ngritet Grupi punues në këtë përbërje;

- 1. Blerina Zeka** zyrtare - Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit kryesuese
- 2. Arbresha Bashota** zyrtare - Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale anëtare
- 3. Florie Humolli** zyrtare - Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë anëtare

Neni 2

Grupi punues, harton propozim programin trevjeçar të banimit, në pajtim me dispozita e Ligjit nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe aktet tjera përkatëse nënligjore në fuqi.

Neni 3

Për punën, detyrat dhe përgjegjësitë grupi punues informon në formë të shkruar Kryetarin e Komunës përmes Drejtorit/eshës së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Anëtarëve të Grupit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 01-020/04-0008157/26
Podujevë, datë; 05.02.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L – 040, nenet 16 dhe 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 dhe nenet 3 parag. 3 dhe 27 paragrafi 1.14 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr. 01-016/01-0030667/22, në kërkesë/rekomandim të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr.02-052/09-0007929/26, datë 04.02.2026, merr:

VENDIM PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Lejohen mjete financiare në shumë të përgjithshme 1650 € për aktivitetet në kuadër të Takimeve të Kulturës “Kadri Kadriu” të mbajtura më 19.12.2025, sipas konkursit letrar për poezi, ese dhe tregime të shkurtra nr. prot. 09-334/07-0076074/25 datë 21.11.2025, të organizuar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe destinohen për përzgjedhurit/përfituesit sipas Listës përfituese si pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit të cilat obligohen për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore sa i përket shpenzimit të parasë publike.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/03-0008300/26
Podujevë, datë: 06.02.2026

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L – 040, nenet 16 dhe 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 dhe nenet 3 parag. 3 dhe 27 paragrafi 1.2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Proceduarat e Ndarjes së Subvencioneve nr. 01-016/01-0030667/22, në rekomandim të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr.prot. 02-052/09-0007974/26, datë 05.02.2026, merr:

VENDIM PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Lejohen mjete financiare në shumë të përgjithshme 3250 € për aktivitetet e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, përkatësisht zgjedhjen e sportistëve të vitit 2025 në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe destinohen për të përzgjedhurit në manifestimin “Zgjedhja e Sportistit të Vitit”, aktivitet i cili është mbajtur më datë 24.12.2025 në kuadër të DKRS.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit të cilat obligohen për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore sa i përket shpenzimit të parasë publike.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/03-0008296/26
Podujevë, datë: 06.02.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafi 1.13 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.09-615/03-0006856/26 të datës 02.02.2026, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Xhafer Ademi, nga Podujeva, për organizimin e manifestimit të ditës nacionale të flamurit të komunitetit ashkali mbështetet me mjete financiare në shumë 1,000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit i cili ka për obligim që pas përfundimit të manifestimit të ditës nacionale të flamurit të komunitetit ashkali të dorëzoj raport lidhur me shpenzimet financiare.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Xhafer Ademi (njoftohet përmes DKRS-së).

Nr.prot 02-400/04-000 9396/26
Podujevë, datë, 11.02.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, jep;

A U T O R I Z I M

Autorizohet z.Faik Rama, nr. personal i letërnjoftimit [redacted] nr. i kartelës identifikuese zyrtare KPO 0071, përfaqësues i Komunës për konteste juridike, të përfaqësojë Komunën e Podujevës në procedura gjyqësore në të gjitha gjykatat, në të gjitha lëndët, përkatësisht çështjet juridike në të cilat Komuna është në cilësinë e paditëses ose të paditurës dhe lidhur me këtë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike.

Autorizimi vlen deri më 31.12. 2026.

Nr.prot. 02-016/01-0009474/26
Podujevë, datë: 12.02.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 23.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë dhe nenet 14, 16 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr;

VENDIM PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në konsultim publik:

- **Draft Programi Trevjeçar i Banimit 2026-2028**

Neni 2

Diskutimi publik sipas këtij paragrafi, zgjat 30 ditë përkatësisht prej datës, **24.02.2026 deri më 24.03.2026**, brenda së cilës Grupi Punues për hartimin e **Draft Programit Trevjeçar të Banimit 2026-2028**, mund të organizoj diskutime/konsultime të ndryshme publike, kurse **Debati i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më 11.03.2026**, duke filluar nga **ora 10:00**, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë debateve publike, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit/konsultimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; **arbrasha.bashota@rks-gov.net** të cilat pastaj përcjellën në Zyrën përkatëse, brenda periudhës së diskutimit/konsultimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: **http://kk.rks-gov.net/podujeve** (**rubrika; aktet për diskutim publik**) dhe në lokalitete të ndryshme aty ku Komuna e vlerëson të nevojshme.

Neni 5

Konsultimi/debati publik zbatohet nga Grupi Punues për hartimin e **Draft Programit Trevjeçar të Banimit 2026-2028**, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga konsultimi dhe debati publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimin ose mospranimin të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas 7 ditë pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 02-016/01-001123H26
Podujevë, datë: 24.02.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 23.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë dhe nenet 14, 16 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr;

VENDIM PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në konsultim publik Draft Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Podujevës 2026-2028

Neni 2

Diskutimi publik sipas këtij paragrafi, zgjat 30 ditë përkatësisht prej datës, 10.03.2026 deri më 10.04.2026, brenda së cilës Grupi Punues për hartimin e Draft Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Podujevës 2026-2028, mund të organizoj diskutime/konsultime të ndryshme publike, kurse Debati i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më 07.04.2026, duke filluar nga ora 10:00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhes - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë debateve publike, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit/konsultimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; liman.zeqiri@rks-gov.net të cilat pastaj përcjellën në Zyrën përkatëse, brenda periudhës së diskutimit/konsultimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik) dhe në lokalitete të ndryshme aty ku Komuna e vlerëson të nevojshme.

Neni 5

Konsultimi/debati publik zbatohet nga Grupi Punues për hartimin e Draft Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Podujevës 2026-2028, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga konsultimi dhe debati publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimin ose mospranimin të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas 7 ditë pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 02-016/01-00 11618126
Podujevë, datë; 02.25.02.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M

Autorizohet **znj.Valbona Ibishi Azemi**, Ushtuese e Detyrës së Drejtorit/eshës të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Administratës derisa **znj.Ditjona Statovci**, Ushtuese e Detyrës së Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi mjekësor, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga dita e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-016/01-0011617/26
Podujevë, datë: 25.02.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Rregulloren MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të datës 25.02.2026, merr:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve

Neni 1

1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2.Mbështetja financiare publike e OJQ-ve, për projekte/programme dedikuar personave me nevoja të veçanta ofrohet nga Buxheti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit 73014.

Neni 2

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:

- 1.1. Teksti i thirrjes publike
- 1.2. Udhëzimet për aplikantët
- 1.3. Formularët e aplikimit
- 1.4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
- 1.5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
- 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
- 2.3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
- 2.4. Deklarata e Partneritetit(nëse është e aplikueshme)
- 2.5 Forma e deklaratës së programeve/projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet

- publike
- 2.6 Deklarata për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur e programin /projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet)
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
- 3.1 Forma e kontratës për financimin e programit/projektit
- 3.2 Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin/programin
- 3.3 Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit/projektit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

1. Përfituesit me projekt/programet e tyre do të njoftohen për kohën e nënshkrimit të kontratave
2. Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-400/03-0011885/26
Podujevë, datë: 26.02.2026

**Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi**

